



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 103/25 Datë: 10.02.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 134 të mbajtur më 06.02.2025, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet** në nivel institucional Kolegji FAMA në Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2025 deri me 30 shtator 2028).
- II:** Obligohet Kolegji FAMA në Prishtinë që deri me 30 shtator, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim planin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji FAMA në Prishtinë ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1497/24, datë 31.07.2024, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim për akreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin FAMA me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 19.11.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Olgun Cicek dhe Domagoj Svirig.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit) ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji FAMA është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht shtatë (7) standarde;
- Substancialisht katër (4) standarde standard të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtarë) ka rekomanduar që Kolegji FAMA të akreditohet për periudhën tre (3) vjeçare, nga 1 tetor 2025 deri me 30 shtator 2028.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 134-të, të mbajtur me 06.02.2025 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegji FAMA dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së.*




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet : _____

- Kolegji FAMA;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.